

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE DURRËS
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
NR. 730 REP
NR. 122/4 KOL

TAKSA U PAGU



KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 30.10.2015 (dy mijë e pesëmbëdhjetë), para meje Notere Ilva Daci, notere pranë Dhomës së Noterëve Durrës, me seli në Lagjia 28 Nëntori, sheshi "Valmi", pall 109/1, shk.1, kt-1, Elbasan, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje kuotash si më poshtë:-----

Z. Briken Rrozhani, shtetas shqiptar, i biri i Gegës lindur në Lezhë më 02.09.1985 dhe banues në Tiranë, i panjohur prej meje noteres, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 027933875 dhe nr.personal I50902057I

(këtu e më poshtë referuar si Shitësi)

dhe

Z. Alban Fejzaj, shtetas shqiptar, i biri i Ferdinandit, lindur më 16.05.1985, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Mine Peza", Pall.226, ap.3, Tiranë, i panjohur prej meje noteres, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 025174077 dhe nr.personal I50516147U-----

(këtu e më poshtë referuar si Blerësi)

Këtej e tutje "**Shitësi**" dhe "**Blerësi**", bashkërisht do te quhen "**Palët**" dhe individualisht secili prej tyre mund të quhet edhe "**Pala**".-----

MEQENËSE

- A. Shitësi është ortak i shoqërisë PIK CREATIVE ,shpk, dhe zotërues i 40% të kapitalit të shoqërisë **PIK CREATIVE** , e themeluar dhe që operon sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit sipas numrit unik të identifikimit të biznesit L12316016A, me seli në adresën, Rruga Pjetër Bogdani, Nr.37, Kati i 2, Tiranë (më poshtë Shoqëria)
- B. Shitësi ka rënë dakort të hyjë në këtë transaksion me blerësin sipas kushteve dhe afateve më poshtë dhe Blerësi ka shprehur interesin e tij në blerjen e kuotës objekt i transaksionit të paraqitur në këtë kontratë që i korrespondon 40% të vlerës së kapitalit të shoqërisë-----



DUKE KONSIDERUAR SA MË SIPËR, Shitësi dhe Blerësi bien dakord që të lidhin këtë kontratë (më poshtë referuar si "**Kontrata**") si vijon:-----

Neni 1 Qëllimi i Kontratës

- 1.1 Shitësi transferon dhe i shet Blerësit, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë, kuotën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë që përbën 40% të kapitalit të Shoqërisë, Blerësi pranon blerjen kundrejt vlerës nominale dhe disponimin e kësaj kuote nga Shitësi sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
- 1.2 Titulli i pronësisë mbi kuotën do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate nga Palët dhe Blerësi do të bëhet pronar me të drejta të plota i 1 (një) kuote në kapitalin e Shoqërisë

Neni 2 Çmimi i Kontratës

2.1 Çmimi i Shitjes sipas kësaj Kontrate është i barabartë me vlerën në total të shitjes së aksioneve kundrejt vlerës nominale, shprehimisht në vlerën në total prej 40.00 lekë (dyzet lekë shqiptare) ("**Çmimi i Shitjes**").-----

2.2 Çmimi i Shitjes është paguar nga Blerësi tek Shitësi nëpërmjet transfertës në para në llogarinë b bankare të Shitësit.-----

Neni 3 Deklarime dhe Garanci

3.1 Shitësi nëpërmjet kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Blerësin se:-----

- a) Shoqëria është person juridik i regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe ushtron aktivitet tregtar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe sipas dispozitave të statutit;-----
- b) Shitësi e zotëron kuotën të lir nga çdo peng, barrë siguroese, hipotekë, pengesë, pretendime të të tretëve, kufizime, të drejtë parablerje si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore;-----
- c) Shitësi zotëron kuotat e tij për llogari dhe në emrin e vet, dhe nuk ekziston asnjë "ortak i fshehtë" ose detyrim përsa i përket ndarjes së fitimit;-----
- d) Shoqëria nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;-----
- e) Shoqëria ka paguar të gjitha detyrimet fiskale në përputhje me ligjin në fuqi dhe parimeve të kontabilitetit.-----

3.2 Blerësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Shitësin se:-----



- a) Blerësi zotëron të gjithë të drejtat ligjore për nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe se këto të drejta nuk janë objekt, apo në kundërshtim, apo nuk përbëjnë shkelje të ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, dekreti ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, subjekt i të cilit është Blerësi, si dhe ndonjë marrëveshje, licence ose angazhimi në të cilin Blerësi është palë që do të cënonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.-----

Neni 5

Tërësia e kontratës dhe ndryshimi i kushteve

5.1 Nëse, në çdo kohë, ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme në bazë të ligjit të aplikueshëm, pavlefshmëria, pasaktësia apo pazbatueshmëria e kësaj dispozite nuk do të çenojë apo shfuqizojë dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Çdo dispozitë e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë tjetër të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme që pasqyron efektet ligjore të së parës. -----

5.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve lidhur me parashikimet në të. Titujt apo emërtimet e shprehura në këtë Kontratë janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi në tekst dhe në këtë kontratë në tërësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate.-----

5.3 Çdo parashikim i kësaj Kontrate mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Kontrate, ndryshimet e kryera verbalisht nuk janë të vlefshme.-----

Neni 6

Juridiksioni dhe mosmarrëveshjet

6.1 Kjo Kontratë bazohet në, dhe zbatohet sipas ligjit shqiptar, dhe interpretimi, vlefshmëria dhe përmbushja e saj realizohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi. Çdo çështje, detyrim apo kusht që nuk parashikohet në këtë Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar dhe dispozita të tjera ligjore të aplikueshme.-----

6.2 Çdo mosmarrëveshje apo kundërshtim si rrjedhojë apo lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve, do të parashtrahet për zgjidhje gjykatës kompetente në Shqipëri nëse palët nuk bien dakord me shkrim.-----

Ky akt përbëhet nga 4 (tre) fletë dhe printohet në 4 (kopje) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 3 kopje i jepen të Palëve dhe një kopje për arkivën e zyrës sime noteriale.-----

Unë, Noterja pasi ia lexova tekstin e kësaj kontrate me zë të qartë dhe të kuptueshëm palëve dhe pasi ara deklaruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, se e kuptuan dhe e gjejnë përmbajtjen e kontratës në përputhje të plotë me thëniet e tyre, e nënshkruan rregullisht në praninë time, dhe unë Noterja vërtetoj këtë kontratë sipas ligjit.-----



SHITËSI

Z. Briken Rrozhani

Briken Rrozhani

BLERËSI


Z. Alban Fejzaj

Alban Fejzaj

NOTERI PUBLIK

Znj. Ilva Daci

Ilva Daci



REPUBLIC OF ALBANIA

Rrozhani
Last name

Briken
First name

Sqiptare/Albanian 027933875
Nationality

Lezhe, Lezhe
Place of birth

02-09-1985
Date of birth

26-11-2009
Date of issue

M
Sex

25-11-2019
Date of expiry

1509020571
Personal ID number


118
Municipality

I<ALB02793387501509020571<<<<<
8509026M1911253ALB<<<<<<<<<<<<<<<<6
RROZHANI<<BRIKEN<<<<<<<<<<<<<<<<<




REPUBLICA E SHQIPËRIE / REPUBLIC OF ALBANIA


IDENTIFICATION ID CARD



name/surname: **Fejzaj**
foreign name:
nationality: **Alban**
place of birth: **Shqipëri/Albanian**
date of birth: **16-05-1985**
date of issue: **03-05-2009**
issuing authority: **MB**



gender: **M**
date of expiry: **02-05-2019**
personal ID no.: **150516147U**



025174077

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|------------------|
| 1. Nurri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L12316016A | |
| 2. Data e Regjistrimit | 16/11/2011 | |
| 3. Emri i Subjektit | PIK Creative | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 10/11/2011 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 10/11/2011 Deri: | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga "Pjetër Bogdani",Nr.37,Kati 2 | |
| 8. Kapitali | 100,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 3,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ofrimi i shërbimeve grafike,dizenjim,editori,dizenjim faqe ëeb,grafike multimediale,fushata promovionale prodhimesh,fushata sociale,packaging,reklama,ilustrime,broshura,katalogje elektronike dhe aktivitete te tjera ne fushen e grafikes,dizenjim realizime mediatike dhe marrëdhënie me publikun,organizim eventesh,tregti materiale per organizim eventesh ndricim,foni,dekorime,konsulence per organizim eventesh,ide per marketing dhe te gjitha aktivitetet e tjera financiare te lidhura me permbushjen e objektit te shoqerise.Cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshem re Republikën e Shqiperise. | |
| 10. Administratori/ët | Briken Rrozhani | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 10/11/2011 | Deri: 10/11/2016 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | Briken Rrozhani | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 40,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 40,00 | |

- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse



| | |
|--|---|
| <i>zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | |
| 13. Ortakët | Ardit Koleci |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 20,00 Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 20,00 |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | |
| 14. Ortakët | Glon Bakalli |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 40,00 Natyre: |
| 14.2 Numri i pjesëve | 1,00 |
| 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 40,00 |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | |
| 15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: PIK Creative Telefon: 0672174728 |
| 17. Statusi: | Aktiv |

Datë: 27/10/2015

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20151028121439167
Data e Rezultatit të Kerkimit: 28.10.2015
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 12:14:39PM
Lloji i Kerkimit: D-400-650-28
Numri i Dokumentit:
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

PIK CREATIVE SH.P.K.



Alban Jp



30.10.2015

RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPERË
TEL/FAX: 355 4 2429906
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

FATURË

Emri i Përdoruesit: ILVA
HYSEN
DACI

Adresa: L 5 MAJI, RR. FETAH EKMECIU
ELBASAN - ELBASAN
SHQIPERË

Nr. i Llogaritëse: 400-650
Date: 28.10.2015
Pershkrimi: D-20151028121439187

Balanca Perpara: Leke 1.400,00
Debi: Leke 1.400,00
Balanca Aktuale: Leke 0,00

Komente:

